



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENSIMIT TË
AKSIONARËVE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE LOKALE

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0210515/20, të dt. 13.11.2020.

II.

Pika II e vendimit të cekur, ndryshon dhe në të thuhet:

Mjetet për kompensimin e aksionarëve do të merren nga ndërmarrjet publike lokale dhe kompanitë rajonale ku ata shërbejnë nga data e emërimit.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen ndërmarrjet publike lokale të Komunës.

III.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-120/02-112384/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta